



Ambasadorja, znj. Luela Hajdaraga ka pritur në një takim Ambasadorin e ri të Emiratave të Bashkuara Arabe në Greqi, dhe jo rezident në Shqipëri, z. Ali Obaid Ali Alyabhouni Aldhaheiri. Gjatë takimit, Ambasadorët diskutuan mbi forcimin e bashkëpunimit ekonomik mes Shqipërisë dhe Emirateve të Bashkuara Arabe, si dhe projekte konkrete bashkëpunimi që do të ndihmojnë në forcimin e lidhjeve tona.



Ambasadorja e Republikës së Shqipërisë, znj. Luela Hajdaraga zhvilloi një takim me Ministren e Kulturës së Greqisë, znj. Lina Mendoni. Gjatë këtij takimi - që kishte në fokus diplomacinë kulturore - u diskutua mbi mundësitë për të forcuar më shumë bashkëpunimin kulturor mes dy vendeve dhe për realizimin e projekteve të përbashkëta kulturore, në të ardhmen.



Në ambientet e Universitetit New York College, në Athinë, u zhvillua promovimi i projektit "Mama Klorin", me ideatore artisten znj. Doreida Xhogu, realizuar me mbështetjen e Ambasadës së RSH në Greqi. "Mama Klorin" është një vepër vizuale që i kushtohet grave emigrante që punojnë si punëtore pastrimi, të cilat rrëfejnë përjetimet e tyre nga jeta përpara dhe pas mbërritjes në Greqi.



Ambasada e RSH-së në Greqi, në bashkëpunim me Shoqatën "Vëllazërimi" organizoi në ambientet e saj promovimin e librit me titull "Vëllazërisht", i autorit Namik Selmani, dedikuar shoqatës së parë të emigrantëve shqiptarë në Greqi "Vëllazërimi". Ky aktivitet bëri bashkë ish kryetarë dhe anëtarë të shoqatës "Vëllazërimi", përfaqësues dhe aktivistë nga "Komuniteti Shqiptar" dhe shoqata shqiptare, si dhe miq të fushës së kulturës.



Ambasadorja, znj. Luela Hajdaraga zhvilloi një takim me Ministren e Kohezionit Social dhe Familjes, znj. Sofia Zacharaki. Në takim u diskutua mbi mundësitë e bashkëpunimit mes kësaj ministrie dhe atyre homologe në Shqipëri, si edhe mbi mbështetjen e komunitetit shqiptar në Greqi, për çështjet dhe fushat që mbulon kjo ministri. U ra dakord për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta.



Në Delfi u zhvillua "Forumi i IX-të Ekonomik i Delfit" - me titull "Tranzicioni i Madh", ku Shqipëria u përfaqësua nga z. Besart Kadia, Zëvendës Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, si panelist në debatin me temë "Evropa dhe Rajoni - Forcimi i bashkëpunimit midis vendeve candidate për zgjerim dhe vendeve anëtare të BE-së, si mjet përshpejtimi për anëtarësim në BE".



Ministrja e Turizmit dhe Mjedisit, znj. Mirela Kumbaro mori pjesë në Konferencën 9-të Botërore "Oqeani Ynë" në Athinë, ku Shqipëria prezantoi nismat, modelin dhe vizionin e saj për një zhvillim të qëndrueshëm. Znj. Kumbaro zhvilloi takime me Ministren e Turizmit znj. Kefalogianni, Ministrin e Mjedisit dhe Energjisë, z. Skylakakis, Ministrin e Punëve të Jashtme, z. Gerapetritis dhe Kryetarin e Bashkisë së Athinës z. Doukas.



Kryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj është pritur në një takim nga Kryetari i Bashkisë së Athinës, z. Haris Doukas, në kuadër konferencës "Athina në Qendrën e Rezistencës Urbane Klimatike dhe Tranzicionit Energjitik", ku u shkëmbyen përvoja dhe pikëpamje lidhur me qëndrueshmërinë ndaj klimës dhe tranzicionin e energjisë urbane. Z. Veliaj mori pjesë gjithashtu në shfaqjen e premierës së filmit "Dy gisht mjalte 2".



Falë bashkëpunimit mes Ambasadës së RSH-së në Greqi dhe producentit Ermal Mamaqi, në ambientet e Village Cinemas është shfaqur premiera e filmit shqiptar "Dy gisht mjalte 2". Me këtë rast, në ambientet e Ambasadës Shqiptare Athinë u zhvillua aktivitet në kuadër të promovimit të filmit, i cili bëri bashkë gazetarë, piktorë, muzikantë, aktorë, balerinë, producentë, regjizorë, artdashës dhe miq.



Ambasadorja, znj. Luela Hajdaraga mori pjesë në takimin e organizuar në kuadër të aktiviteteve të Grave Ambasadore në Greqi. Takimi bëri bashkë gra nga fushat e diplomacisë dhe gazetarisë që ndanë së bashku opinione mbi një gamë të gjerë temash, përfshirë zhvillimet e fundit në Greqi e më gjerë, stabilitetin rajonal, avancimin e barazisë gjinore dhe çështje të tjera me interes.



U realizua me sukses projekti "Ishujt 2024" për ofrimin e shërbimeve konsullore në Kretë, Rodos dhe ishujt përreth. Janë ofruar në total 903 shërbime, duke iu shërbyer çdo qytetari që u paraqit në sportelet e zyrave të caktuara. Nga bebe të porsalindura e deri te personat në moshë të thyer, kanë marrë shërbim këto ditë, duke reduktuar kostot dhe distancat e largëta.